

Adresari I OJQ-ve për Evropën Juglindore

Adresari dhe Rezultatet e Analizës të Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor



QENDRA RAJONALE PËR MJEDISIN
Zyra në Kosovë (territor nën administrimin e OKB-së)

Adresari i OJQ-ve të Kosovës

*Adresar i OJQ-ve dhe fakte të dala nga studimi i organizatave
mjedisore të shoqërisë civile në Kosovë*

Editoi
MERITA FAZLIU MEHMED

Prishtinë, Kosovë
NËNTOR 2006



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER



DIÇKA PËR REC

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) është organizatë ndërkombëtare neutrale, jo-avokuese, dhe jo fitim-prurës me mision për të ndihmuar në zgjedhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Qendra e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave jo-qeveritare, qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor, dhe duke përkrahur shkëmbimin e lire të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendim-marrjen për mjedis.

REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC ligjërisht zë vend në kartën e nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve, Komisionit Evropian, dhe në marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyret fushore dhe zyret e shteteve në 17 vendet përfituese në vazhdim: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Republika Çeke, Estoni, Hungari, Letoni. Lituani, IRJ e Maqedonisë. Mal të Zi, Poloni, Rumania, Serbi, Sllovakia, Slloveni dhe Turqi.

Donatorët aktual janë Komisioni Evropian dhe qeveritë e Austrisë, Belgjikës, Bosnës dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Republikës Çeke, Kroacisë, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Gjermanisë, Hungarisë, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Holandës, Norvegjisë, Polonisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Suedisë, Zvicrës, Britania e Madhe, dhe Shteteve të Bashkuara, gjithashtu edhe institucionet tjera ndër-qeveritare dhe private..

E tërë përmbajtja e këtij publikimi është e drejtë autoriale ©2006 Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të shitet në asnjë formë apo të ri-prodhohet për shitje pa lejen me shkrim të cilën e ka vetë autori

ISBN: 978-963-9638-30-3

Publikuar nga:

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore

Ady Endre ut 9-11, 2000 Szentendre, Hungari

Tel: (36-26) 504-000, Faks: (36-26) 311-294, E-mail: info@rec.org,

Web faqe: <www.rec.org>

Printuar në Hungari nga Typonova

Ky publikim dhe të gjitha publikimet e tjera të REC-ut janë printuar në letër të ricikluar ose letër të prodhuar pa përdorimin e klorit ose produkteve të klorit

Shkurtesat	4
Mirënjohje dhe falënderime	5
Harta e Kosovës	6
Parathënia	7
Metodologjia e vlerësimit	9
Shembull i një profili të OJQ-së	10
Si të përdoret ky Adresar	11
Adresari i OJQ on-line	13
Organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Kosovë	15
Krahasimi mes të dhënave nga 2001 dhe 2006	16
Korniza ligjore & rregullative	17
Baza e resurseve	19
Kapacitetet njerëzore dhe organizative	19
Baza e informatave dhe njohurive	20
Llogaridhënia	23
Adresari i organizatave mjedisore të shoqërisë civile	25
Shtojca: Pyetësi i plotë – Pjesa A dhe B	37

SHKURTESAT

BeH	Bosnja e Hercegovina
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Euro
GIS	Sistemi i Informatave Gjeografike (Geographical Information System)
LA21	Local Agenda 21
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
PLVM	Plani Lokal për Veprim në Mjedis
POP	Ndotësit organikë të qëndrueshëm (Persistent Organic Pollutants)
REC	Qendra Rajonale për Mjedis (Regional Environmental Center)
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik i Mjedisit

Mirënjohja dhe falënderime

Përgatitja e një publikimi si ky kërkon një përkushtim të madh nga një grup i madh njerëzish, posaçërisht kur merret parasysh se është synuar të përgatitet Adresari dhe njëkohësisht të kryhet edhe një studim i thukët i iniciativave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë. Për më shumë i gjithë procesi ishte i ngjeshur në një periudhë gjashtë mujore. Për këtë arsye e kemi parë të nevojshme të falënderojmë shumë njerëz që kanë qenë të përfshirë në zhvillimin e këtij publikimi, për të gjithë punën dhe kontributin e tyre të vlefshëm.

Fillimisht mirënjohja dhe falënderimet tona i drejtohen mbështetësit të projektit, gjegjësisht Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida) dhe stafit të saj, përkatesisht zonjave Helen Holm dhe Magdalena Svensson, të cilat bënë të mundshme që REC të përfshijë këtë publikim në programin SECTOR, i cili është një program i gjerë për përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile në Evropën Jug-Lindore.

Falënderimet tona i drejtohen edhe 30 organizatave mjedisore të cilat plotësuan Pyetësin si dhe 15 përfaqësuesve të organizatave jo-qeveritare dhe të institucioneve qeveritare të cilët u intervistuan si pjesë e këtij studimi. Ky Adresar është zhvilluar me qëllim që tu ndihmojë atyre në misionin e vet dhe shpresojmë se do të jetë i dobishëm në këtë aspekt.

Koordinimi i punëve që ndërldheshin me përpilimin e Adresarit është udhëhequr nga Zyra e REC në Kosovë, me ç'rast duhet të përmendim Dr. Zeqir Veselaj i cili ishte një prej të intervistuarve dhe i cili mbikëqyri gjithë punën e zyrës, Merita Fazliu Mehmed e cila udhëhoqi procesin e shpërndarjes dhe mbledhjes të pyetësorëve si dhe përpunimin e të dhënave, si dhe Fitore Ferizi dhe Naim

Arifaj të cilët ndihmuan në përpunimin dhe përkthimin e materialit. Një falënderim i veçantë i drejtohet edhe kolegëve tanë në REC zyra në Tiranë të cilët na mbështetën në përkthimin dhe editimin e materialit.

Në vijim po përmendim edhe personat kyç për dizajnimin dhe kryerjen e gjithë studimit: ekipin kryesor në REC, i cili zhvilloi metodologjinë e studimit, dizajnoi pyetësorët, kreu intervistat në vendet përkatëse, analizoi të dhënat dhe shkroi pjesën faktike për të gjitha vendet, ekip ky i cili përbëhej prej: Robert Atkinson, Adriana Craciun, Richard Filcak, Dana Carmen Romanescu, Jerome Simpson, Stephen Stec, Orsolya Szalasi, Kaidi Tingas dhe Magdolna Toth-Nagy. Szilvia Pandi Szegedi e cila mblodhi dhe përpunoi të dhënat në format elektronik dhe bëri të mundur që të analizohen të gjitha të dhënat e nxjerra nga pyetësorët. Erzsebet Aszalos, Entela Pinguli dhe Todd Schenk që dhanë përkrahje shtesë si dhe Laszlo Leitold i cili udhëhoqi administrimin financiar të projektit. I jemi mirënjohës edhe Profesor JoAnn Carmin nga Instituti i Massachusetts për Teknologji për kontributin e saj në përgatitjen e pyetësorëve.

Sa i përket publikimit, njerëzit në vijim ishin ata që mundësuan përgatitjen dhe shtypjen e materialit: thyerja dhe dizajni u krye nga Patricia Barna, mbështetur nga Sylvia Magyar, teksti u lekturua nga David Landry dhe Steven Graning. Emese Gal mbështeti të gjithë procesin e përgatitjes së publikimit, përdërisa Richard Filcak dhe Robert Atkinson kontribuan në editimin e tekstit dhe të dhënave dhe koordinuan procesin me Merita Fazliu Mehmed e cila ishte përgjegjëse për editimin e versionit kosovar.

Merita Fazliu Mehmed
Editor



Parathënie

Ky publikim që përfshinë Adresarin e OJQ-ve mjedisore në Kosovë, si pjesë shtesë ka edhe një përshkrim të fakteve dhe të gjeturave gjatë vlerësimit të gjendjes së organizatave të shoqërisë civile kosovare.

Vlerësimi dhe Adresari janë produkt i një programi më të madh për përkrahje të OJQ që aktualisht është duke u implementuar nga REC. Ky program, i titulluar Përkrahja e Organizatave të Shoqërisë Civile në Evropën Jug-Lindore (SECTOR), do të zgjasë prej vitit 2006 - 2010 dhe është financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Edhe pse programi si i tillë përbëhet prej formave të ndryshme të përkrahjes, si që janë ndarja e granteve për mbështetje të projekteve, vlerësimi organizativ, asistenca për rrjetëzim dhe ngritje kapacitetesh në këtë drejtim, duke synuar që përfundimisht të arrihet një forcim i rolit të organizatave të shoqërisë civile në fushat e mjedisit urban dhe qëndrueshmërisë urbane.

Nga vlerësimi i kryer dolën tri rezultate. I pari, vlerësimi u mundëson organizatave mjedisore të përfshihen në Adresarin e azhurnuar të nivelit nacional dhe rajonal (EJL). I dyti, vlerësimi reflekton gjendjen aktuale të organizatave mjedisore dhe ambientin në të cilin ato operojnë, si dhe ofron një analizë të thellë të sfidave dhe mundësive më të cilat këto organizata ballafaqohen. I treti, vlerësimi e ndihmon REC-un në përgatitjen dhe planifikimin e formave tjera të përkrahjes që do të ofrohen si pjesë e programit SECTOR.

Ky Adresar është dizajnuar ashtu që të jetë një instrument për të gjithë ata që punojnë me organizata mjedisore të shoqërisë civile si dhe për ata që vet punojnë në organizata të tilla. Adresari në formën e tij të shtypur si dhe në formën

elektronike on-line, është një resurs që mund të përdoret lirshëm nga të gjithë të interesuarit.

Të dhënat e përfshira aty tregojnë emrin e organizatës edhe në gjuhët vendore edhe në gjuhën angleze, së bashku me informatat kontaktuese, aktivitetet kryesore dhe prioritetet në mënyrë që lexuesit t'i ofrohet një pasqyrë e qartë rreth punës së secilës organizatë.

Nuk pretendojmë se në këtë Adresar kemi përfshirë të gjitha grupet mjedisore të shoqërisë civile kosovare mirëpo jemi të sigurt që kemi përfshirë një numër të madh të atyre që janë aktive në këtë fushë. Ka qenë e pashmangshme që në kryerjen e një vlerësimi kaq të gjerë për një kohë të shkurtër ka pasur raste kur organizatat nuk kanë arritur të përgjigjen në kohën e caktuar, apo raste tjera kur neve na kanë ikur gabime gjatë futjes së të dhënave. Ne kërkojmë falje për rastet e tilla. Këto grupe gjithsesi mund t'i dërgojnë kontaktet e tyre në REC duke e përdorur formularin e bashkangjitur këtu, apo në formën e elektronike përmes webfaqes së REC <www.rec.org/REC/Databases/NGO_Directory_SEE/Find.html> ku kontaktet e tyre do t'i bashkëngjiten Adresarit i cili do të freskohet me të dhëna të reja gjatë gjithë kohës. Kjo siguron që versioni elektronik i Adresarit do të jetë sa më i saktë dhe sa më i plotë që është e mundur.

Metodologjia e vlerësimit

Vlerësimi dhe përpilimi i Adresarit është zhvilluar në tri faza:

- mbledhja e të dhënave nga burimet e hapura;
- shpërndarja e pyetësorit (i cili u përdor për futjen e të dhënave në Adresar) tek një audiencë e gjerë e organizatave mjedisore të shoqërisë civile; dhe
- intervistat e gjysmë strukturuara individuale (shitesë për vlerësimin).

Me këtë qëllim janë mbledhur të dhëna kuantitative dhe kualitative.

Fokusi i hulumtimit ishte organizuar rreth dy temave kryesore të ndara në pesë module. Tema e parë ishte gjendja, situata, progresi zhvillimor i shoqërisë civile mjedisore (ambienti i brendshëm i punës) kurse tema e dytë kishte të bëjë me kushtet ligjore, ekonomike sociale dhe mjedisore posaçërisht se si këto kushte ndikonin punën e organizatave (ambienti i jashtëm i punës). Studimi u zhvillua rreth moduleve vijuese:

- korniza rregullative dhe ligjore;
- baza e resurseve;
- kapacitetet njerëzore dhe organizative;
- baza e informatave dhe njohurive; dhe
- llogaridhënia.


Pyetësori i kryer ju shpërnda organizatave mjedisore (meqenëse studimi u dedikoej grupeve mjedisore e jo individëve) nga zyret lokale të REC në muajt Qershor dhe Korrik 2006. Pyetësori ishte i ndarë në dy pjesë: të dhënat nga Pjesa A u përdorën për të përpiluar pyetësorin, përderisa pyetjet nga Pjesa B kishin për qëllim vlerësimin më të thellë të grupeve, mirëpo kjo është pjesë konfidenciale dhe nuk i

është bashkangjitur informatave specifike për organizatat përkatëse. Të dhënat e futura aty u përdorën për pjesën analitike të studimit të REC, për të vlerësuar gjendjen dhe nevojat e lëvizjes mjedisore në EJL (shih Shtojcën 1 për të parë Pyetësorin e plotë).

Forma elektronike e pyetësorit u publikua në webfaqet e REC prej nga mund të shkarkohej, si dhe u shpërnda përmes postës elektronike dhe formave tjera të komunikimit. Zyra kryesore e REC në bashkëpunim me zyrën lokale përpiloi pyetësorin në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Organizatat mjedisore të shoqërisë civile duhej ta plotësonin dhe ta dorëzonin sërish në REC pyetësorin e plotësuar. Pyetësorët e dorëzuar u përkthyer dhe u futën në data bazën rajonale në gjuhën angleze si dhe në gjuhën shqipe dhe atë serbe për qëllim të përgatitjes së këtij publikimi edhe në gjuhët e vendit. Pyetësori u plotësua nga gjithsejtë 30 organizata.

Në fazën e fundit të hulumtimit në terren (Korrik - Gusht 2006) ekipi i REC kreu 16 intervista personale, gjysmë të strukturuara me udhëheqësit e organizatave mjedisore në Kosovë, ekspertë ligjor, donator, përfaqësues të qeverisë dhe palë tjera. Të gjeturat kryesore janë përmbledhur në këtë tekst ndërsa rekomandimet janë dhënë në një raport të veçantë.

Publikimi është i strukturuar në tri pjesë kryesore. Hyrja (ku përfshihen qëllimet dhe metodologjia), analiza vendore (ku përfshihet një krahasim mes të dhënave të vitit 2001 dhe 2006 të mbledhura nga REC), dhe pjesa e fundit është Adresari i OJQ-ve. Në kapitullin vijues mund të gjeni informata mbi përdorimin e Adresarit.



* Për kodet specifike, shih listën e kodeve në kapakun e botimit.

Si të përdoret Adresari

Kapitulli mbi analizën vendore përmban një hartë të vendit dhe një pasqyrë të përgjithshme të sektorit të OJQ-ve, bazuar në të dhënat statistikore të mbledhura gjatë përpilimit të pyetësorit të vitit 2006. Në pjesën e Adresarit, OJQ-të janë radhitur sipas alfabetit në bazë të shkronjës së parë të qytetit prej nga vjen organizata. Në rastet kur disa OJQ vijnë nga qyteti i njëjtë radhitja është bërë në mënyrë alfabetike sipas emrit të organizatës.

Për secilën OJQ të listuar janë përfshirë informatat në vijim:

- Emri i grupit/organizatës/Emri i grupit/organizatës në anglisht dhe forma e shkurtër e emrit
- Informatat kontaktues: përfshirë adresën, telefonin, faksin, adresën elektronike dhe webfaqen;
- Personi kontaktues – për kontakt në rast të pyetjeve lidhur me organizatën;
- Personi përgjegjës – personi i cili ligjërisht e përfaqëson OJQ-në;
- Viti i themelimit apo vitin kur organizata filloi punën;
- Numri i anëtarëve të regjistruar në organizatë;
- Numri i punëtorëve që punojnë në organizatë me orar të plotë apo me gjysmë orari (punëtorë të paguar) dhe numrin e vullnetarëve;
- Buxheti vjetor është paraqitur duke përdorur njërin prej kodeve prej B1 deri B9. Për vlerat e sakta të këtyre kodeve ju lusim të shikoni kolonën B të pyetësorit;
- Burimet e financimit të organizatës janë paraqitur duke përdorur njërin prej kodeve F1 deri F7; konsultoni kolonën përkatëse në pyetësor për shpjegime më të hollësishe;
- Publikimet kryesore të organizatës;

- Nivelin e aktivitetit, apo nivelin ku organizata është aktive. Këtu ka katër nivele të ndryshme duke filluar nga ai lokal, rajonal brenda vendit, nacional dhe internacional. Organizata mund të operojë në disa prej niveleve të përmendura;
- Anëtarësimi në ndonjë organizatë ombrellë, aty ku organizata në fjalë ka një rol aktiv;
- Gjuhët e folura dhe të shkruara nga anëtarët brenda organizatës;
- Fushat tematike ku organizata është aktive janë paraqitur duke përdorur kodet T1 deri T26. Për të parë listën e plotë të këtyre kodeve shih pyetësorin e plotë të bashkangjitur;
- Aktivitetet e implementuara në vazhdimësi nga organizata janë radhitur në kodet prej A1 deri A25. Për të parë listën e plotë të këtyre kodeve shih pyetësorin e plotë të bashkangjitur;
- Interesin e organizatës për të lidhur partneritet me OJQ tjera është radhitur duke shfrytëzuar kodet: PP1 Lokal, PP2 Nacional, dhe PP3 Internacional;

Komente: një përshkrim i shkurtër ku paraqiten të arriturat kryesore, projektet e kryera, etj, relevante për organizatën;

- Vetëm fushat të cilat janë plotësuar nga OJQ janë paraqitur në profilin e organizatës të dhënë në këtë publikim;

Për më shumë, me qëllim të lehtësimit të identifikimit të ndonjë OJQ më lehtë janë përfshirë dy indekse ku janë radhitur organizatat:

- Sipas vendit dhe sipas emrit të OJQ-së (në Anglisht) në radhë alfabetike;
- Sipas fushave prioritare dhe vendit në radhë alfabetike.

Adresari i OJQ-ve, versioni on-line

Organizatat mjedisore nga Kosova të cilat morën pjesë në vlerësim poashtu janë përfshirë edhe në Adresarin e OJQ të EJJ, versioni on-line, që mund të gjendet në adresën e mëposhtme elektronike: <www.rec.org/REC/Databases/NGO_Directory_SEE/Find.html>.

Kjo data bazë shumë e lehtë për tu përdorur, e cila do të azhurnohet vazhdimisht, ofron katër mundësi kërkimi të cilat mund të përdoren ndaras apo në çfarëdo lloj kombinimi me njëra tjetrën:

- OJQ sipas vendit
- OJQ sipas lokacionit (qytetit)
- OJQ sipas emrit (versioni Anglisht)
- OJQ sipas fushës prioritare të aktiviteteve (bazuar në listën për zgjedhjen e prioriteteve).

Web faqja e Adresarit të OJQ-ve ofron edhe disa mundësi shtesë:

- Mund të shtypni listën e të gjitha OJQ-ve apo të dhënat për OJQ-të individuale
- Mund të dërgoni vërejtje dhe sugjerime sa i përket përmirësimit të kualitetit të Adresarit
- Dërgoni kërkesa elektronike për të pasur një kopje të shtypur të Adresarit të OJQ-ve
- Dërgoni të dhënat e një organizate që dëshironi të futet në këtë Adresar

Përveç kësaj, organizatat të cilat nuk janë përfshirë në këtë Adresar mund të fusin të dhënat e tyre dhe do të përfshihen në data bazën e organizatave mjedisore të shoqërisë civile.

Pasqyrë e përgjithshme

TË DHËNAT E KTHYERA

Pyetësorët e plotësuar **30**

REGJISTRIMI

Numri i OJQ të regjistruara dhe jo të regjistruara zyrtarisht **30 të regjistruara**
0 të paregjistruara

ANËTARËSIMI NË ORGANIZATA

Numri i anëtarëve në Kosovë (gjithsejtë në vend) **2,878**

Anëtarët për OJQ **prej 3 deri 550**

Mesatarja e anëtarëve për OJQ **96**

NUMRI I PUNËTORËVE

Stafi i paguar (me orar të plotë apo gjysmë orari) **105**

Punëtorë pa pagesë (vullnetarë) **2,601**

Proporcioni staf me pagesë/pa pagesë **1:25**

BUXHETET VJETORË

Kosovë: Totali i buxheteve të OJQ-ve **382,500**

Buxheti mesatar (i përafërt) **12,750**

Rangu më i zakonshëm i buxhetit **37% të buxheteve të OJQ-ve hyjnë në kategorinë 1 (nuk ka buxhet)**

Përqindja e OJQ-ve mjedisore në vijën më të lartë dhe më të ulët buxhetore dhe kontributi i tyre kundrejt totalit të buxheteve

- 37% e OJQ mjedisore (kategoria 1, nuk ka buxhet) përbëjnë 0% të totalit të buxheteve vjetore të OJQ-ve
- 3% OJQ-ve mjedisore (kategoria 8, buxhet mbi 100,000 EUR) përbëjnë 26% të totalit të buxheteve vjetore të OJQ-ve

3 BURIMET KRYESORE PËR FINANÇIMIN E OJQ

FS6 donacione/grante nga fondacione ndërkombëtare/të huaja **76.7%**

FS3 grante të sektorit publik ndërkombëtar apo donacione/qeveri të huaja **56.7%**

FS5- donacione/grante nga fondacione vendore **50%**

5 FUSHAT PRIORITARE KRYESORE PËR OJQ-TË MJEDISORE NË KOSOVË

T11 edukimi mjedisor/edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm **90%**

T17 mbrojtja e natyrës **80%**

T18 zhvillimi rural **73.4%**

T19 zhvillimi i qëndrueshëm **70%**

T12 legjislacioni mjedisor **63.4%**

3 AKTIVITETET KRYESORE PËR OJQ-TË MJEDISORE NË KOSOVË


A2 fushata vetëdijesimi **93.4%**

A7 edukim **90%**

A6 konferenca, takime **86.6%**

GRAFIKONI 1.

Viti i themelimit në OJQ-ve mjedisore në Kosovë (%)



Kategoria 1 – deri më 1990


Kategoria 2 – 1991-1995

Kategoria 3 – 1996-2000

Kategoria 4 – 2001-2006

GRAFIKONI 2.

Niveli i Punës



(rajonet brenda vendit)

Krahasimi i të dhënave mes viteve 2001 dhe 2006

Nga studimi i zhvilluar me organizatat mjedisore të shoqërisë civile këtë vit vërehet një rritje domethënëse nga 12 organizata që REC-u kishte përfshirë në Adresarin e 2001 në 30 sosh që do të përfshihen në Adresar këtë vit. Shumica e të dhënave tjera sugjerojnë rritje të përgjithshme në sektor praktikisht në të gjitha aspektet.

Jo befash, numri i pjesëmarrësve është rritur nga 539 në 2,878 në vitin 2006. Nga krahasime të tjera vërehet se mesatarja e anëtarëve të organizatës është ngritur nga 45 në 96. Krahasuar me vetëm 10 punëtorë me pagesë në 12 organizata nga viti 2001, organizatat kosovare raportojnë se kanë 105 punëtorë me orar të plotë apo të përgjysmuar. (Në përqindje prej 3.5 punëtorë për OJQ). Numri i vullnetarëve është rritur nga 66 në vitin 2001 në 2,601 në vitin 2006.

Në vitin 2001, 12 OJQ mjedisore kanë menaxhuar me buxhet prej rreth 274,000 euro. Për vitin 2006, 30 grupet së bashku arrijnë një buxhet mesatar prej 382,500 euro. Si i tillë buxheti i organizatës, i llogaritur për afërsisht, është rritur nga 22,833 në 12,700 gjatë vitit. Mirëpo, nëse shikojmë më për afërt shpërndarjen e mjeteve, shohim se numri i organizatave me buxhet më pak se 500 euro është ngritur në mënyrë të vullshme prej vitit 2001, nga 8 për qind në 42 për qind, në krahasim me grupet e vëzhguara pesë vite më vonë. Dy OJQ mjedisore kanë pasur buxhet më shumë se 100,000 euro në vitin 2001, derisa numri i tyre është zvogëluar në një në vitin 2006. Të dhënat financiare tregojnë se krahasuar me pesë vite më parë grupet kosovare kanë më pak fonde në dispozicion këtë vit.

Përderisa në të dy vitet (2001 dhe 2006) burimi kryesor për financimin e aktiviteteve të OJQ-ve mjedisore kanë qenë donatorët e jashtëm, tarifa e anëtarësisimit e cila është llogaritur si burimi i dytë kryesor në 2001 (42%), ka pësuar një ulje të dukshme në 2006. Grantet vendore mbesin burimi i tretë i të hyrave, por numri i OJQ-ve mjedisore që raportojnë të kenë marrë

fonde të tilla është ngritur në 33% deri 50% të atyre që plotësuan pyetësin.

Në fushat e aktiviteteve prioritare ka disa ndryshime të rëndësishme (të cilat sigurisht janë shkaktuar nga organizatat e reja që janë shtuar në vitin 2006). Edukimi mjedisor është radhitur si fusha kryesore e punës në të dyja vitet. Mirëpo përveç mbrojtjes së natyrës, që është e pranishme në të dy vitet, shohim një tendencë animi të theksuar drejt zhvillimit rural, zhvillimit të qëndrueshëm dhe legjislacionit mjedisor, përdorimit të kualiteti/ndotja e ajrit nuk radhitet në top pesë - shin gjatë vitit 2006.

Fushatat për vetëdijësim, edukim si dhe mbledhjet/konferencat janë aktivitetet më të rëndësishme për OJQ-të mjedisore në vitin 2006, krahasuar me pastrimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijës dhe edukimin në vitin 2001. Shkurtimisht, shumica e metodave të punës kanë mbetur të njëjta gjatë këtyre viteve.

Sa i përket trendit të formimit të organizatave, ashtu siç mund të pritej, ai dominohet nga grupet e themeluara pas vitit 2000. Sidoqoftë, niveli i punës ka filluar të ndryshojë. Përpara, grupet kanë punuar më shumë në nivelin lokal, por tashti aktivitetet regionale janë më të përhapura. Përveç kësaj puna në nivelet nacionale dhe internacionale është gjithashtu

në ngritje në krahasim me ditët e hershme të pas konfliktit.

Korniza ligjore dhe rregullative

Involvimi i lartë i komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, në teori ka mundësuar që korniza ligjore për regjistrim të OJQ-ve mjedisore të jetë e qartë dhe e thjeshtë. Janë parë përmirësime të mëdha në administrimin e regjistrimit qysh prej kur Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes morën përsipër përgjegjësitë nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Sidoqoftë, për shkak të situatës së rëndë financiare në vend, nga shumë të anketuar regjistrimi konsiderohet të jetë një barrë e rëndë. Ligji kërkon ndihmë ligjore për regjistrim edhe pse shumica mendojnë që nuk është e nevojshme.

Situata dhe sfidat unike të Kosovës në zhvillimin e strukturës qeveritare kanë kontribuar në perceptimin e përgjithshëm se nga pikëpamja ligjore gjërat mezi janë duke funksionuar. Mungesa e nëpunësve me përvojë dhe revidimi i plotë i ligjeve kanë kontribuar në krijimin e një situatë ku vetëm ato institucione dhe ligje më kritike për mbijetesën e popullsisë janë në të vërtetë relevante. Për më tepër ndryshimi i sfonteve dhe standardet kanë bërë që shumë ligje të mbesin peng mes

Faktet kryesore: Korniza ligjore dhe rregullative

- Korniza ligjore për regjistrimin e OJQ-ve është e mirë dhe praktika administrative është përmirësuar.
- Edhe pse punohet sipas të njëjtës kornizë ligjore, në praktikë për OJQ-të mjedisore nga pjesa më e madhe e Kosovës dhe për OJQ-të që operojnë në enklavat serbe aplikohen standarde tjera për punë.
- Zbatimi i ligjit dhe i obligimeve tatimore është i lirshëm, dhe OJQ-të mjedisore veprojnë duke i kushtuar pak vëmendje çështjeve ligjore.
- Korniza ligjore për informim, pjesëmarrje dhe çështje të tjera të rëndësishme për OJQ-të mjedisore janë zhvilluar mirë në bazë të standardeve internacionale.
- Institucionet jo adekuate, mungesa e burimeve dhe administrimi i dobët kontribuojnë në mungesën e zbatimit të kornizës ligjore, përveç atyre ligjeve më kritike që ndikojnë në popullatë.

qeverisë dhe UNMIK-ut. Me fjalë të tjera OJQ-të mjedisore veprojnë në Kosovë duke i kushtuar shumë pak vëmendje aspektit ligjor. Për shembull, krahasuar me vendet tjera të rajonit, shumë më pak OJQ mjedisore në Kosovë u përbahen obligimeve për raportim financiar.

OJQ-të mjedisore në enklavat serbe nuk paguajnë taksa në përgjithësi duke u arsyetuar me vështirësitë në transport, komunikimin dhe të tjera kushte lidhur me raportet e tyre me autoritetet qendrore. Përderisa zbatimimi është i dobët thuhet se ai ndodh. Në anën tjetër, një pjesë e madhe e fondeve të OJQ-ve vjen nga grantet ndërkombëtare të liruara nga taksat. Korporatat mund të zbresin 5% e të hyrave nga donacionet, edhe pse për shkak të definicionit

të gjerë, shumica prej tyre përdorën për mbështetjen e klubeve sportive, ndarjen e bursave dhe mbështetjen e individëve.

Në Kosovë struktura ligjore për qasje në drejtësi thuhet se nuk ekziston. Sidoqoftë në krahasim me vendet fqinje në rajon OJQ-të mjedisore të Kosovës kanë një mendim paksa më të mirë rreth kornizës ligjore dhe zbatimit të ligjit. Edhe pse komuniteti ndërkombëtar ka imponuar standardet ndërkombëtare, në përgjithësi në Kosovë nuk hasim mosbesimin në ligj të cilin e hasim në BeH dhe i cili rezultoi në mendimi më të ulët për ligjin. Standardet ndërkombëtare vlerësohen dhe kuptohen, por në përgjithësi konsiderohen si të paarrtshme. Edhe korniza ligjore për informacion dhe pjesëmarrje nuk

Faktet kryesore: **Baza e resurseve**

- OJQ-të mjedisore kosovare kanë një varësi të kuptueshme nga burimet financiare ndërkombëtare.
- Burimet ndërkombëtare të financimit janë në rënie, ndërrojnë prioritetet e veta apo shtrëngojnë kushtet për financim.
- Ndryshimi i prioriteteve të donatorëve ka rezultuar në ndryshimin e aktiviteteve të OJQ-ve.
- Buxheti i Qeverisë tani për tani është tepër i kufizuar për të mbështetur ndarjen e fondeve në masë të madhe, e përveç kësaj edhe qasja e qeverisë kundrejt shoqërisë civile nuk bënë pjesë në prioritetet e larta.
- Shumë OJQ mjedisore përdorin projektet e tyre për të mbështetur të pagat fillestare të anëtarëve të vet (Pseudo – konsultim).
- Buxhetet për OJQ-të mjedisore në Kosovë janë përkeqësuar nga viti 2001 (numri më i madh nuk ka fare buxhet). Si e tillë vërehet një ndarje e madhe mes organizatave me fonde dhe atyre pa to, duke reflektuar kështu një krizë të madhe për financim. Është brengosëse që tre çerek e OJQ-ve mjedisore në Kosovë vlerësojnë se janë në gjendje financiare jo stabile apo të dobët.
- OJQ-të mjedisore kosovare duket të kenë strategji më të dobët për mbledhjen e fondeve se sa në vendet tjera të Evropës Jug-Lindore, duke rezultuar me “shuarjen” e OJQ-ve mjedisore kosovare prej njërit në tjetrin projekt dhe duke shkaktuar kështu probleme të mëdha për mbajtjen e stafit.
- Edhe pse, OJQ-të mjedisore në Kosovë, në të shumtën e rasteve posedojnë zyrat e veta, shumë vështirë i përballojnë harxhimet që lidhen me mbajtjen e tyre.
- Zhvillimi i filantropisë së organizuar nga qytetarët dhe biznesi nuk duket se ka gjasa të zhvillohet në klimën sociale dhe ekonomike të tanishme.
- Tarifat për anëtarësim, në afat të shkurtë dhe të mesëm, dhe nuk duken si burim i mjaftueshëm për të hyrat e OJQ-ve mjedisore kosovare.

Faktet kryesore: **Kapacitetet njerëzore dhe organizative**

- OJQ-të mjedisore në Kosovë nuk janë të zhvilluara sa duhet dhe kanë mungesë të stafit me përvojë pune.
- Instrumentet për planifikim strategjik dhe procedurat administrative në përgjithësi janë të njohura nga OJQ-të mjedisore, por nuk përdoren për sigurimin e efektivitetit ose efikasitetit të organizatës.
- OJQ-të mjedisore funksionojnë në nivel mesatar. Sidoqoftë ato kanë probleme në zhvillimin e aktiviteteve të cilat do t'i përgjigjeshin dhe do të reflektonin më mirë nevojave të qytetarëve.
- OJQ-të mjedisore shumë shpesh varen nga donatorët dhe iu mungon mbështetja qeveritare.
- Nuk ka mjaft mbështetje institucionale për OJQ-të mjedisore, posaçërisht ato të minoritetit serb.

bënë përjashtim këtu. Është e kualitetit të lartë por praktikisht jo relevante. Një numër i OJQ-ve konsiderojnë kuadrot me ekspertizë ligjore si një nevojë të madhe. Vetëm disa programe trajnuese mbi ligje, u janë dhënë OJQ-ve mjedisore.

Bazat e resurseve

Në Kosovë financimi për OJQ-të mjedisore më së shumti vjen nga burimet e huaja, sikur nga agjencitë qeveritare ashtu edhe nga fondacionet e ndryshme. Çdo ndryshim i prioriteteve të tyre apo çdo reduktim në fonde nga këto burime, do të kishte një ndikim të madh në komunitet. Në të vërtetë, kjo veç ka filluar të vërehet në një numër të madh të OJQ-ve mjedisore kosovare, të cilat ose shumica prej atyre që kanë projekte kryejnë aktivitete jashtë fushës së tyre fillestare apo janë të involvuara në rolin e konsulentëve. Për më tepër te OJQ-të mjedisore kosovare është krijuar një “mentalitet i kërkimit të ngushtë” duke mos kërkuar (apo duke mos qenë në gjendje të kërkojnë) përtej burimeve të shënjuara për Kosovën.

Burimet vendore sidomos nga qeveria janë të pakta dhe duhet të bëhen ndryshime që mbështetja për shoqërinë civile të institucionalizohet. Sidoqoftë buxheti i qeverisë është mjaft i kufizuar dhe statusi i paqartë sjell

edhe pasiguri financiare. Megjithatë edhe burime të tjera, sado të vogla qofshin ato (p. sh. taksat mjedisore), do të duhet institucionalizuar me qëllim që të arrihet një strukturë e qëndrueshme e fondeve. Mekanizmi i sjelljes së fondeve duhet përpunuar, veçanërisht nga aspekti i sigurimit që përkrahja ndahet në mënyrë ta barabartë te të gjitha grupet etnike. Ndoshta kjo më së miri do të arrihej duke deleguar vendimmarrjen në nivelet lokale.

OJQ-të mjedisore financiarisht janë në gjendje shumë më të dobët se sa në vitin 2001. Një numër i madh i tyre nuk ka fare burime financiare. Gjendja e tillë tregon se komuniteti mjedisor nuk ka qasje në burimet e fondeve të shumëllojshme dhe se mundësitë për vetë gjenerimin e të ardhurave dhe zhvillimi i filantropisë janë ende në fazat fillestare. Kur kësaj i bashkohet edhe përvoja e dobët e OJQ-ve mjedisore në gjetjen e fondeve krijohet hapësirë për dyshim se kjo situatë mund të thellohet në një krizë të zgjatur për lëvizjen mjedisore. Është e domosdoshme përkrahje shtesë, por në formë të duhur, që të përmirësohet situata e tanishme.

Kapacitetet njerëzore dhe organizative

Në përgjithësi, edhe pse OJQ-të mjedisore në Kosovë janë të vetëdijshme për instrumentet e

udhëheqjes strategjike dhe për procedurat administrative, si dhe rëndësinë e tyre për funksionim më të mirë, vetëm një numër i vogël i tyre i përdorë ato metoda. OJQ-të mjedisore në Kosovë shihen si shumë të dobëta në aspektin e strukturës, programeve dhe ekspertizës. Janë pak të dukshme në shoqëri dhe nuk janë partner efektiv me qeverinë.

Është e qartë se organizatat mjedisore kanë një bazë shumë të dobët të financimit, varen nga donatorët dhe e kanë shumë të vështirë të bashkëpunojnë dhe operojnë jashtë territorit të tyre për arsye të mungesës së përvojës dhe mundësi të pakta për të konkuruar në nivel rajonal. Kjo situatë është e kuptueshme për një vend ku organizatat mjedisore janë shumë të reja stafi i të cilave në të shumtën e rasteve ka edhe një punë tjetër jashtë angazhimit në organizatë.

Shumë prej organizatave kanë kryer vlerësimin e nevojave trajnuese mirëpo nuk ka pasur trajnime sistematike për ngritjen e kapacitetit të stafit; në të shumtën e rasteve trajnimet janë mbajtur ad-hoc. Përdorimi i kufizuar i planit strategjik vjen si pasojë e mungesës së kapacitetit dhe njohurisë për zhvillimin e tij. Asistenca për zhvillimin e vizionit dhe strategjisë, së bashku me sistemet administrative si p.sh menaxhimi financiar ende paraqiten si nevoja kyçe për trajnim. Nga intervistat e kryera lihet të kuptohet se është e nevojshme një qasje tjetër trajnuese nga ajo që është përdorur deri më tani. Kjo qasje do të duhej të fokusohet në mundësitë ku stafi i organizatave do të mund të fitoj dhe të përdorë përvojat e veta përmes trajnimeve gjatë punës dhe në mundësitë për shkëmbim ndërkombëtar të stafit me organizatat tjera.

Vetëm një numër i vogël i organizatave konsideron se kanë performuar me sukses të plotë vitin e kaluar, përderisa shumica e organizatave performancën e vet e vlerësojnë të jete mesatare ose pjesërisht të suksesshme. Arsyet e dhëna si shkaqe për suksesin e kufizuar, në të shumtën e rasteve lidhen me: mungesën e motivacionit (meqë njerëzit nuk paguhen), varshmëria nga donatorët (përshtatja konstante me programet e tyre), faktorët e

jashtëm (mungesa e fondeve, nivel i ulët i vetëdijesimit dhe mungesa e vizionit mjedisor si nga ana e institucioneve të përkohshme ashtu edhe nga komuniteti) si dhe mungesa e përkrahjes nga autoritetet lokale.

Përderisa vet organizatat mjedisore vlerësojnë se kanë bazë të fortë të stafit ekspert, ide të mira dhe reagojnë ndaj nevojave reale, është me rëndësi të ceket se palët tjera në këtë fushë nuk kanë një vlerësim kaq pozitiv dhe konsiderojnë që OJQ-ve mjedisore në Kosovë u mungon vizioni, transparenca dhe llogaridhënia dhe orientimi i tyre përcaktohet nga orientimet e donatorëve.

Organizatave kryesisht punësojnë 3.5 punëtorë dhe kanë mesatarisht 200 vullnetarë për organizatë. Anëtarësimi në organizatave është përgjithësisht i mirë, posaçërisht kur kihet parasysh interesi i ulët i popullatës në çështjet mjedisore dhe njohurive të pakta mbi aktivitetet e OJQ-ve. Përderisa shumica e anëtarëve i bashkëngjiten kësaj lëvizjeje nga vullneti për të ndikuar dhe për të ndryshuar diçka në shoqëri, shumica largohen nga ajo pasi kuptojnë se sa i nënzhvilluar është sektori. Edhe pse OJQ-të mjedisore në Kosovë në përgjithësi kanë një balancë të mirë gjinor, lëvizja mjedisore karakterizohet me numër më të madh meshkujsh se femrash.

Baza e informatave dhe njohurive

Sa i përket ambientin operues të OJQ-ve mjedisore, 55% e vlerësojnë disponueshmërinë me informacion mjedisor dhe me informacion rreth zhvillimit të qëndrueshëm si adekuat, përderisa 29% e vlerësojnë atë si jo adekuat. Shumë nga organizatat që u përgjigjën në pyetësorin tonë mendojnë se informacioni është i pakët dhe se edhe informacioni në dispozicion është i kualitetit të dobët. Kjo duket të ndërlidhet me faktin se nuk ka sistem të monitorimit mjedisor. Ka disa informata zyrtare nga zyra për edukim dhe ndërgjegjësim pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe në internet, mirëpo shumë nga organizatat nuk kanë qasje deri të këto informata, të cilat edhe ashtu duket të jetë të mangëta.

Faktet kryesore: **Baza e informatave dhe njohurive**

- Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për monitorim mjedisor ndikon edhe në disponueshmërinë e mangët të informatave mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin urban.
- Informacioni zyrtar në dispozicion të OJQ-të mjedisore është i kualitetit të dobët (të dhëna të vjetra, të paraqitura dobët, dhe jo të besueshme) shpërndarja e të cilit pengohet edhe nga konfliktet e interesit dhe mos vlerësimi i kërkesave të përdoruesit të fundit.
- Shpërndarja e informacioneve rreth zhvillimit të qëndrueshëm dhe informacioneve mjedisore (si proaktive dhe pasive) është e dobët dhe OJQ-të mjedisore kërkojnë përmirësime në këtë drejtim, qoftë edhe në shpërndarjen e informacioneve nga vet OJQ-të mjedisore.
- Gati të gjitha OJQ-të mjedisore mirëpresin përmirësimet në shkëmbimin e informatave me autoritetet, sikur fizike ashtu edhe virtuale.
- Rreth gjysma nga të gjitha OJQ-të mjedisore posedojnë një koleksion librash, broshurash dhe raportesh mjedisore dhe një numër më të vogël të materialeve tjera. Një numër i madh konsiderojnë njohuritë dhe kapacitetet/ aftësitë e organizatave të tyre, në fushën ku punojnë, të jenë “adekuate”. Megjithatë, të gjitha mirëpresin trajnime shtesë që të rrisin njohuritë e tyre të brendshme.
- OJQ-të mjedisore nuk kanë tendencë që në mënyrë të pavarur të kryejnë hulumtime të ndryshme, nëse këto nuk janë të financuara si pjesë e ndonjë projekti.
- Fletushkat dhe broshurat janë format më popullarizuara të botimit të informacioneve. OJQ-të përdorin postën elektronike, postaret/ prezantimet për të shpërndarë informata.

Kur flitet për kualitetin, praktikisht të gjitha OJQ-të konsiderojnë që është e nevojshme të përmirësohet kualiteti i informacionit zyrtar në fushat vijuese: saktësia (95%), prezantimi (95%), dhe besueshmëria (72%). Një sfidë tjetër e cekur nga OJQ-të ka të bëjë edhe me faktin se shumë biznese private dhe interesa tjerë nuk kanë vullnet të shpërndajnë informatat. Sa i përket shpërndarjes proaktive të informacionit më shumë se 80% e organizatave mendojnë se përmirësimi është i nevojshëm (sa i përket qasjes në informacion, shpërndarje përmes mediave, shpërndarja në kohë, formati elektronik dhe bërja publike e informacionit përmes qendrave për informim publik). Ministria konfirmon se planifikon të themeloj një zyre informative. Sidoqoftë, shumë nga OJQ-të konsiderojnë se ministria duhet të mbështeten më shumë me organizatat e shoqërisë civile sa i përket informimit meqenëse këto organizata janë në kontakt të

drejtpe drejtë me çështjet dhe mund të reagojnë në shpejt dhe më konkret. Përgjigja zyrtare ndaj kërkesave për informacion në të shumtën e rasteve u vlerësua negativisht. Sa i përket përmirësimit të mekanizmave për shkëmbim të informacionit me autoritetet, 89% preferojnë forumet fizike përderisa 94% preferojnë ato virtuale.

Në lidhje organizimin e vetë OJQ-ve mjedisore, përafërsisht 45% posedojnë koleksion të librave mjedisor, broshurave dhe raporteve, përderisa 39% posedojnë materiale tjera (publikime nga shtypi, të dhëna dhe statistika monitorimi). Tetëdhjete e gjashtë për qind konsiderojnë njohuritë dhe kapacitetet/ aftësitë e organizatave të tyre, në fushën ku punojnë, të jenë “adekuate”. Megjithatë, të gjitha mirëpresin trajnime shtesë që të rrisin njohuritë e tyre të brendshme, sidomos duke pasur parasysh se mungesa e fondeve pengon ngritjen e mëtutjeshme të kapaciteteve.

Faktet kryesore: **Llogaridhënia**

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis vendosin një kornizë për bashkëpunim me OJQ-ve dhe autoritetet mjedisore. Dispozitat e këtyre akteve ligjore ftojnë OJQ-të të ulen në këshille drejtuese dhe komisione këshillimi së bashku me trupat qeveritar, mirëpo këto dispozita nuk specifikojnë kushtet e përzgjedhjes së OJQ-ve pjesëmarrëse. Përzgjedhja kryesisht kryhet në bazë të kontakteve personale dhe vëshirë mund të thuhet se cili është ndikimi i përfaqësuesve të OJQ-ve në këto raste.
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është e vetëdijshme për rëndësinë e bashkëpunimit me OJQ-të mirëpo nuk ka as mjetet financiare e as njohuritë dhe kapacitetet e nevojshme për të organizuar këtë bashkëpunim. Megjithatë ministria kë një bashkëpunim më të afërt me rrjetin e OJQ-ve mjedisore Sharri.Net.
- Përkundër politikave ekzistues nuk vërehet ndonjë bazë e mirëfilltë për bashkëpunim me OJQ dhe ky bashkëpunim është shumë i rrallë dhe me një qasje ad-hoc. Bashkëpunimi aktual bazohet kryesisht në kontribut ekspertësh nga OJQ-të e ndryshme në hartimin e planeve dhe strategjive zyrtare.
- Shembuj më pozitiv të bashkëpunimit mund të gjinden në nivel lokal (me fokus në projekte informimi dhe vetëdijesimi si dhe në aksione të ndryshme pastrimi).
- Edhe pse disa OJQ që stimulohen nga komuniteti dhe janë të interesuara të dëgjojnë dhe të përfaqësojnë nevojat ekzistuese të komunitetit, shumica prej tyre udhëhiqen nga orientimet e donatorëve dhe nuk përfaqësojnë në mënyrë të denjë nevojat e komunitetit lokal.
- Edhe bashkëpunimi me bizneset lokale është i kufizuar. Nuk ka praktika të mirëfillta ku bizneset private përkrahin aktivitetet e ndërmarra nga OJQ-të.
- Korniza ligjore për qasje në informata dhe pjesëmarrje të publikut përgjithësisht (me disa përjashtime) është në nivel, mirëpo mungojnë udhëzime praktike se si do të zbatoheshin në praktike këto procedura.
- Ka pak njohuri apo udhëzime për proceduar për qasje në informacion dhe për pjesëmarrje të publikut. OJQ-të mjedisore nuk ushtrojnë të drejtën e tyre për të marr informacione dhe për të qenë pjesë e vendimmarrjes, përveç kësaj, OJQ-të dhe autoritetet nuk dinë se si të arrijnë grupet e tyre të targetuara dhe si të organizojnë një proces të mirëfilltë të vendimmarrjes.
- Komisionet parlamentare janë të hapura për publikun; OJQ-të mjedisore mund ti përdorin ato për të dhënë komentet dhe kontributin e tyre në draft dokumentet e ndryshme legislative.
- Rezultati i konsultimeve publike zakonisht nuk është i kënaqshëm për autoritetet publike, ngase OJQ-të mjedisore shpesh nuk ofrojnë kontributin e pritur në përgatitjen e draft dokumenteve. Përveç kësaj, OJQ-të mjedisore kanë prirje të tërhiqen nga procesi i konsultimit kur shohin se procesi po shkon në një drejtim të padëshiruar. Megjithatë ka disa shembuj të mirë ku autoritetet kanë udhëhequr konsultime të mira sidomos në fushën e VNM-se dhe ku është kërkuar ekspertizë e caktuar nga OJQ-të e ndryshme.

Kur flitet për mbledhjen dhe hulumtimin e të dhënave mjedisore dhe atyre mbi zhvillimin e qëndrueshëm OJQ-të mjedisore në Kosovë nuk kanë tendencë që në mënyrë të pavarur të

kryejnë hulumtime të ndryshme, nëse këto nuk janë të financuara si pjesë e ndonjë projekti. Përafërsisht gjysma e OJQ-ve mjedisore në Kosovë përdorin pajisje

kompjuterike për menaxhimin e të dhënave dhe vetëm 31% përdorin data baza për këtë qëllim. Fletushkat dhe broshurat janë format më populërizuara të botimit të informacioneve. OJQ-të përdorin postën elektronike, postaret/prezantimet (100 për qind e OJQ-ve të anketuara) për të shpërndarë informata. Forma tjera më tradicionale për shpërndarjen e informatave janë edhe artikujt apo njoftimet e ndryshme nëpër gazeta vendore, raporte apo fletushka të shtypura, telefoni dhe faksi. Organizatat përkrahëse të OJQ-ve mjedisore të anketuara vlerësojnë se OJQ-të kanë praktika të mira për shpërndarjen e informacionit dhe shfrytëzojnë shumë mirë mediat ekzistuese.

Llogaridhënia

Një rishikim i gjendjes aktuale sa i përket llogaridhënies në Kosovë në fushën e strukturës administrative dhe praktikave për implementimin e parimeve dhe të drejtave të dala nga Konventa Aarhus sugjeron se, me përjashtim të disa rasteve të pakta, kërkesat e Konventës Aarhus në përgjithësi janë përfshirë në legjislacionin vendor. Megjithatë zbatimi i këtyre parimeve dhe të drejtave në praktikë është mjaft i mangët në shumë aspekte, pjesërisht për arsye të mungesës së kapacitetit dhe vetëdijes së autoriteteve përkatëse dhe OJQ-ve për ti vënë të drejtat e tyre në praktikë. Vetëm rishtazi ministria e mjedisit është bërë më aktive në këtë fushë dhe fakti që edhe vet OJQ-të nuk janë shumë të njohura me të drejtat e Konventës Aarhus e vështirëson situatën.

Mënyra se si autoritetet e trajtojnë informacionin mjedisor nuk testohet nga OJQ-të. Informacioni që jepet përmes internetit apo mjeteve tjera është i dobët dhe duhet përmirësuar edhe sa i përket kualitetit, kohës së dhënies dhe saktësisë. Kërkesat për pjesëmarrje të publikut nuk mbështeten me procedura dhe udhëzime konkrete që do të definojnë obligimet e autoriteteve si dhe do tu ofronin atyre instrumentet e nevojshme për t'i jetësuar obligimet që dalin nga legjislacioni.

E drejta për qasje në drejtësi nuk ushtrohet si duhet, kryesisht për arsye të përvojës së mangët dhe të vetëdijes së ulët publike sa i përket proceseve gjyqësore që mund të iniciohen.

Bashkëpunimi mes OJQ-ve mjedisore dhe autoriteteve qeveritare ekziston në një masë mirëpo jo në masë të kënaqshme për asnjërën palë. Përkundër disa vendeve tjera në rajon, bashkëpunimi mes OJQ-ve dhe autoriteteve kërkohet edhe me ligjet mjedisore mirëpo nuk përkrahet me rregullore apo akte tjera më specifike. Përfaqësuesit e OJQ-ve mjedisore mund të përzgjidhen dhe të marrin pjesë në shumë borde apo komisione këshilluese por ndikimi i tyre këtu nuk është i mjaftueshëm.

Bashkëpunimi i OJQ-ve mjedisore me qytetarët zakonisht ndodh në ditë të caktuar me rëndësi mjedisore (Dita e Tokës), fushata publike, dhe iniciativa tjera që lidhen me projekte specifike. OJQ-të mjedisore nuk i kanë të zhvilluar mekanizmat për kuptimin e mendimit të vërtetë publik; në të shumtën e rasteve udhëhiqen nga orientimet e donatorëve e jo nga nevojat e komunitetit lokal. Edhe bashkëpunimi me bizneset lokale është i kufizuar. Ka pasur raste bashkëpunimi me bizneset lokale mirëpo ende nuk ka praktika të mirëfillta ku bizneset private përkrahin aktivitetet e ndërmarra nga OJQ-të.

DEÇAN

Shoqata e Intelktualëve të Pavarur*Association of Independent Intellectuals (SHIP-AII)*Pallati i kulturës "Jusuf Gërvalla" Deçan 51000
Deçan, Kosovë

Tel: +377 44 182 689

Adresa e postës elektronike:

a_ship2002@yahoo.co.uk,

ademlushaj@hotmail.com

WEB Faqja: Nuk ka

Drejtues: Adem Lushaj, Drejtor ekzekutiv**Person kontakti:** Adem Lushaj & Beqir Kadriaja**Viti i krijimit:** 2000**Viti i regjistrimit:** 2000**Statusi i regjistrimit:** Shoqatë**Numri i punonjësve:** 3**Numri i anëtarëve:** 50**Numri i vullnetarëve:** 15**Buxheti vjetor:** EUR 50,001-100,000**Burimi i financimit:** FS3, FS5, FS6**Fushat kryesore:** T2, T7, T11, T12, T13, T14, T17, T18, T19,
T21, T24, T25, T26**Aktivitetet:** A1, A2, A3, A4, A5, A6, A7, A8, A9, A10, A11,
A12, A13, A14, A15, A16, A17, A19, A20, A21, A22, A24, A25**Shtrirja e aktivitetit:** Lokal, rajonal, kombëtar**Anëtar i një organizate ombrellë:** Sharr-net, AVOKO,Civic bridge, FOD, mozaiku, bridges of friendship, Forumi
ndërkufitar mjedisor TEF**Gjuhët:** Shqip, anglisht, serbo-kroate,**Botimet kryesore:** Në kuadër të aktiviteteve janë botuar

edhe fletushka që të informohen qytetarët edhe me

çështjet por edhe me të arriturat si p.sh. ta ruajmë

bukurinë e natyrës sonë, jo ndotjes, institucionet në

shërbim të qytetareve, etj. dhe këto ne çdo 3 muaj.

Komente:

Kemi arritur suksese të shumta për çështjet mjedisore si në

aspektin e avokimit dhe në aspektin e ruajtjes dhe

rregullimit. Duhet potencuar përgatitjen dhe më pas

aprovimin nga asambleja komunale të rregullores për

mbeturinat inerte, pajisjen e shkollave me kontejner 1.1 m3

dhe shporta te vogla, pajisjen e disa fshatrave me kontejner

familjar, krijimin e Agjensionit për Pastrim Rural, që punon

në grumbullimin e mbeturinave nëpër vise rurale dhe

ambulantat, vendosjen e shportave për mbeturina nëpër

qendër të qytetit, etj.

DEÇAN

Agjensioni për Pastrim Rural*Agency for Rural Cleaning (APR)*Pallati i Kulturës "Jusuf Gervalla" Deçan 51000
Deçan, Kosovë

Tel: +377 44 182 689

Adresa e postës elektronike:

ura_qytetare@yahoo.com

